



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

**FJALIMI I KRYETARIT TË PREZENCËS SË OSBE-SË NË SHQIPËRI,
AMBASADORIT EUGEN WOLLFARTH
Konferenca për Lidershipin e Gjqësorit
*Tiranë, 20 prill 2012***

Ministër Halimi,
Ambasadorë,
Znj. Vata,
Zonja dhe zotërinj,

Konferenca e sotme është e rëndësishme, domethënëse dhe e nevojshme.

Në emër të Prezencës së OSBE-së mund të them me gjithë zemër se jemi shumë të lumtur t'i bashkohemi përpjekjeve që po bëhen sot.

Do të doja të uroja Projektin JUST të USAID-it dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë për organizimin e këtij aktiviteti. I njëjti falënderim shkon për të gjithë pjesëmarrësit, për praninë e tyre dhe për kontributin në zhvillimin e mëtejshëm të Lidershipit të Gjqësorit në Shqipëri.

Gjykatat vendase duhet të jenë një shtyllë e demokracisë në çdo vend.

Gjykatat vendase duhet të jenë një shtyllë e demokracisë në Shqipëri.

Kur funksionojnë siç duhet, gjykatat sjellin në jetë të drejtat ligjore të qytetarëve duke bërë drejtësi në mënyrë të paanshme.

Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që gjykatat t'i shërbejnë publikut me kompetencë, transparencë dhe përgjegjshmëri.

Në Shqipëri – administrimi i drejtësisë meriton dhe duhet të jetë shumë më i mirë.

Kjo është një pikëpamje e pranuar gjerësisht si në vend dhe jashtë tij.

Nevoja për ndërhyrje në këtë fushë është identifikuar edhe si një faktor kyç për aspiratat e Shqipërisë dhe prospektit për integrimin evropian, si dhe në drejtim të përmbushjes së angazhimeve të OSBE-së.

Në këtë kontekst, miratimi nga Qeveria i Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2011-2013 dhe Planit të Veprimit sigurisht që shënon një hap të rëndësishëm në drejtimin e duhur.

Përpjekjet e Projektit JUST për të rritur përdorimin e dhomave të gjykatave dhe për të prezantuar regjistrimin audio, janë gjithashtu të rëndësishme dhe të lavdërueshme.

Sidoqoftë, nevojiten përpjekje më të mëdha nga të gjithë aktorët për të përmirësuar cilësinë e funksionimit të gjykatave dhe kështu duke ndërtuar dhe përforcuar besimin e publikut.

Ofrimi i ndihmës për procesin e reformës gjyqësore ka qenë një nga detyrat kryesore tradicionale të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Është kënaqësi profesionale të nënvizoj që rekomandimet e Prezencës, të përfshira në dy raporte të mëparshme mbi vëzhgimin e gjyqeve, formojnë bazën e diskutimeve të tanishme të Grupit të Punës për Reformën e Procedurës Penale që punon nën drejtimin e Ministrisë së Drejtësisë.

Ne kuptojmë gjithashtu që rekomandimet për përmirësimin e procedimeve civile pritet të ndahen me aktorët e interesuar më vonë gjatë këtij viti.

Aktiviteti i sotëm do të përqendrohet në çështje kyçe teknike dhe praktike që do të japin kontribut për rritjen e rolit të gjyqësorit.

Temat që do të diskutohen sot – rritja e përdorimit të dhomave të gjykatave, regjistrimi audio dhe menaxhimi aktiv i rasteve – patjetër që do të ndihmojë gjyqtarët të përmirësojnë cilësinë e gjyqeve të tyre.

Rritja e përdorimit të dhomave të gjykatave dhe regjistrimi audio rrisin transparencën e procedimeve, ndërsa teknikat e menaxhimit aktiv të çështjeve kontribuojnë për gjyqe me efektshmëri më të madhe.

Dhe kjo do të ndihmojë për uljen e ngarkesës së punës për gjykatësit si dhe për rritjen e besimit të publikut.

Hapa të tillë konkret do të ndihmojnë përmirësimin e shërbimeve të dhëna për publikun nga ana e gjykatave.

Sidoqoftë, reforma gjyqësore nuk mund të arrihet pa një partneritet të vërtetë dhe efektiv ndërmjet gjykatave, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Qeverisë, Parlamentit dhe partnerëve ndërkombëtar të Shqipërisë, duke përfshirë projektin JUST dhe Prezencën e OSBE-së.

Aftësia për të bërë përmirësime të vërteta dhe afatgjata do të rrjedhë vetëm nga përpjekjet e koordinuara dhe vullneti profesional për të ecur përpara.

Përvoja ndërkombëtare e vendeve të tjera do të sugjeronte që forca e partnerëve ndërkombëtar qëndron në të qenit të aftë për të ofruar shembuj dhe përvoja të përshtatshme ndërkombëtare.

Në shumicën e rasteve, nuk ekziston nevoja për të ‘shpikur rrotën nga e para’.

Ka të bëjë më shumë me zgjedhjen se cila ‘rrotë’ e testuar ndërkombëtarisht është më e përshtatshme për Shqipërinë.

Ju jeni ekspertë të procedurave ligjore shqiptare dhe të detajeve të nevojshme për funksionimin e gjyqësorit.

Ju jeni ata që kanë pozicionin më të mirë për të vlerësuar se në çfarë mase janë përvojat ndërkombëtare të përshtatshme për Shqipërinë – për të zgjedhur një rrotë cilësore sipas nevojave tuaja.

Sidoqoftë, ne kuptojmë që të jesh pjesë e gjykatave shqiptare nuk është një punë e lehtë.

Është një sfidë e përditshme profesionale për të shërbyer si gjykatës apo menaxher gjykatë.

Presioni i tepruar, që ndonjëherë bashkohet me mungesën e infrastrukturës logjistike, nuk krijon kushtet e duhura për të pasur rezultate të efektshme.

Sidoqoftë, kjo nuk duhet t'ju shkurajojë nga përpjekjet e vazhdueshme për t'i ofruar publikut drejtësi brenda kohës së duhur.

Ministër Halimi,
Zonja dhe zotëri,

Unë dua t'ju uroj një konferencë të suksesshme dhe t'ju siguroj përsëri që Prezenca e OSBE-së në Shqipëri është e gatshme për të dhënë ndihmë të mëtejshme, së bashku me partnerët tanë ndërkombëtarë dhe kombëtarë.

Ju faleminderit!

Fund